



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА E МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

## VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-1137/1 të datës 17.02.2023, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent sepse bëhet fjalë për denoncim anonim nga i cili nuk ka mundësi të jepen informata shtesë.

Lënda me numër 12-1137/1 të datës 17.02.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 17.02.2023, një parashtrues i panjohur ka paraqitur denoncim për gjoja parregullsi financiare në funksionimin e \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_, për të cilën është përcaktuar rasti me numër 12-1137, datë 12.02. Bëhet fjalë për parregullsi në punën e personit juridik në fushën e financave dhe pagesës së të ardhurave mujore të punonjësve.

Bëhet fjalë për pagesën e një shtesë pagash prej 0.35% për personat pjesëmarrës në komisionin e zbatimit të prokurimit publik të institucionit, e gjitha kjo është formalizuar me një marrëveshje kolektive të nënshkruar, të lidhur ndërmjet drejtorit të institucionit në fjalë dhe kryetar i organizatës sindikale. Duke qenë se prokurimi publik është pjesë e çdo institucioni dhe është një nga detyrat e rregullta të punës që kryhen përmes një komisioni të formuar të përbërë nga punonjës, shtrohet pyetja se si pjesëmarrësit në

komisionet e tjera të punës nuk e kanë atë shtesë në pagë që u paguhet punonjësve dhe anëtarëve të komisionit të prokurimit publik.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent, për faktin se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar atë që u vu në dukje dhe për rrjedhojë nuk ka mundësi për të dhënë informacion shtesë, pa s[ cilës mori vendim që denoncimi të hidhet poshtë .

Sipas sa më sipër KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

përgatiti: P.B  
miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së.

**KOMISIONI SHTETËROР  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska